REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. ____ prot. Tiranë, më ___ . ___ . 2022

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - dhjetor 2021, miratuar me vendimin nr. 02 prot, datë 28.02.2022, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grup i Menaxhimit Strategjik, relacioni dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për vitin 2021, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në PBA-në (2021-2023).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2021, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 90 çështje. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2021, Kolegji ka rregjistruar për shqyrtim 97 çështje (86 çështje të juridiksionit të rivlerësimit dhe 11 çështje të juridiksionit disiplinor).

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit në zbatim të ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, janë përcaktuar në vlerën 157,150 mijë lekë. Për shkak të nevojave të paraqitura gjatë vitit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar një shtesë në fondin e veçantë të institucionit për vlerën totale 114 mijë lekë. Plani për periudhën 12-mujore është **157.364 mijë lekë** dhe realizimi **149.734 mijë** lekë ose **95.2 %**.

Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Llogaria ekonomike	Emertimi	Plani vjetor	Realizimi vjetor	% realizimit
6000000	Paga	119.900	119.834	99.9%

6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetsore	11.100	10.809	97.4%
6020000	Mallra dhe shërbime	16.900	15.337	90.8%
6060000	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.364	906	66.4%
2310000	Investime Kapitale	8.000	2.848	35.6%
	Totali	**157.364**	**149.734**	**95.2%**

I - <u>Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)</u>

Buxheti fillestar i miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2021, në paga është **115.7 milionë lekë.** Në kushtet kur ky fond ishte i pamjaftueshëm për pagesën e pagave të punonjësve të strukturës organike prej 49 (dyzet e nëntë) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 82/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", përfshirë dhe pagesën e shtesës për vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe pagave për 6 (gjashtë) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar në VKM-në nr. 1151, datë 24.12.2020, është kërkuar në vijimësi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, një shtesë në fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2021. Si rezultat i përgjigjeve negative nga ana e ministrisë, Kolegji me qëllim plotësimin e nevojave, ka kërkuar transferimin e fondeve brenda programit buxhetor nga artikulli 602 " Mallra dhe shërbime" në artikullin 600 " Paga", në vlerën 4.2 milionë lekë. Kjo kërkesë është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 16525/1 prot., datë 04.10.2021. Pas rialokimit të kryer, fondi i pagave për vitin 2021, u rrit në vlerën **119.9 milionë lekë** dhe përbën 76 % të buxhetit total vjetor. Realizimi i buxhetit për këtë kategori shpenzimesh për periudhën janar- dhjetor 2021, është **119.83 milionë** lekë ose 99.9%. Me buxhetin në dispozicion në paga për vitin 2021, pas rialokimit të kryer, është bërë e mundur pagesa e punonjësve sipas parashikimeve në legjislacion si dhe pagesa e tre pagave mujore gjatë vitit, si shtesë për vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimit në nenin 29, pika 5, të ligjit 84/2016, si dhe vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 17, datë 30.07.2019. Gjithashtu bazuar në VKM-në nr. 801, datë 20.12.2021 "Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar", fondi i mbetur i pagave në vlerën 465 mijë lekë, është përdorur për shpërblim të punonjësve të administratës së Kolegjit.

II - <u>Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)</u>

Buxheti i miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2021, në sigurime shoqërore dhe shëndetësore është **9.3 milionë lekë**. Pas rialokimit të fondeve, nga artikulli 602 " Mallra dhe shërbime" në artikullin 601 "Sigurime shoqërore", në vlerën 1.8 milionë lekë, fondi i sigurimeve për vitin 2021, u rrit në vlerën **11.1 milionë lekë** dhe përbën 7 % të buxhetit total vjetor. Realizimi i buxhetit për këtë kategori shpenzimesh për periudhën janar- dhjetor 2021, është **10.8 milionë** lekë ose 97.3%. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për pagat.

III - <u>Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)</u>

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2021, në shpenzime operative është **24 milionë lekë**. Pas transferimit të fondit 1.1 milion lekë nga artikulli 602 " Mallra dhe shërbime të tjera" ne artikullin 606 "Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet" (sipas parashikimit në udhëzimin plotësues nr.4, datë 25.01.2021, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021), për rimbursimin e shpenzimeve telefonike sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 855, datë 04.11.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 02.09.2020, "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë", si dhe rialokimit të fondit 6 milion lekë, të kryer nga shpenzimet operative në shpenzime personeli, buxheti për mallra dhe shërbime për vitin 2021, zbriti në vlerën **16.9 milionë lekë,** që përbën 11% të buxhetit total vjetor.

Realizimi i buxhetit për këtë kategori shpenzimesh për periudhën janar- dhjetor 2021, është **15.3 milionë** lekë ose 91%.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

N/artik	Struktura e llogarive	Plani vjetor (në lekë)	Fakti Progresiv (në lekë)
602	**Mallra dhe Shërbime të tjera**	**16,900,000**	**15,337,056**
	Materiale Zyre dhe të Përgjithshme	**4,272,000**	**4,049,927**
6020100	Kancelari, letër	700,000	640,381
6020200	Materiale për pastrim e higjeno sanitare	600,000	502,560
6020200	Materiale elektrike, ndricim etj	26,000	-
6020300	Materiale për funks.e zyrave (tonera)	2,257,400	2,255,016
6020300	Pjese këmbimi fotokopje	620,000	620,000
6020400	Mat. për funksionimin e pajisjeve speciale	19,000	-
6020900	Furniz.dhe materiale tjera zyrë dhe të përgj	50,000	31,970
	Materiale dhe shërbime speciale	**817,000**	**613,972**
6021001	Uniforma	120,000	-
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore	6,000	5,765
6021004	Furnizime me ushqim per mencat (Ujë)	300,000	256,900
6021007	Posta abonim ne shtypin e shkruar	90,000	88,356
6021010	Shpenz. prodhim dokumentacioni specifik	100,000	81,720
6021099	Dezinfektim i ambienteve	101,000	100,368
6021099	Të tjera mater.dhe shërbime speciale	100,000	80,863
	Shërbime nga të tretë	**3,669,000**	**3,511.073**
6022001	Elektricitet	1,564,000	1,518,576
6022002	Ujë	100,000	71,422
6022003	Shërbime telefonike celulare	700,000	629,147
6022003	Shërbime telefonike fiks	40,000	24,473
6022004	Posta dhe shërbim korrieri	100,000	113,055
6022007	Sherbime bankare	10,000	-
6022010	Shërbime të printimit dhe publikimit	1,155,000	1,154,400
	Shpenzime transporti	**439,000**	**430,680**
6023100	Karburant dhe vajra	181,000	180,720
6023300	Shpenzime siguracioni të mjeteve	60,000	51,960
6023900	Shpenzime parkimi për automjetin	198,000	198,000
	Shpenzime udhëtimi	**5,000**	**500**
6024100	Udhetim i brendshëm.	5,000	500
	Mirëmbajtje të zakonshme	**580,000**	**216,508**
6025500	Shpenz. Mirëmb. sisteme dhe instalime	450,000	98,400
6025600	Shpenz.për mirëmb.e mjeteve të transportit	110,000	109,108
6025800	Shpenzime per miremb. e paisjeve të zyrave	20,000	9,000
	Shpenzime të tjera operative	**7,117,600**	**6,514,396**
6029001	Shpenzime për pritje e percjellje.	100,000	-
6029004	Shpenz. për sig e jetës, shëndetit dhe pronës	6,400,000	6,028,700
6029005	Shpenzime pagese ekspert të jashtëm	20,000	8,500
6029006	Shpenzime kompes telefonie gjyqtarë	139,000	138,300
6029006	Shpenz kompes pasaporte diplomatike	14,000	-
6029008	Shpenz. për tatim & taksa	150,000	97,500
6029099	Masat e mbrojtjes nga zjarri	13,000	12,960
6029099	Materiale hidraulike,marangozi, ndërtimi	50,000	17,040
6029099	Dekorimi i festave të fundvitit	20,000	-
6029099	Licensa Microsoft Office dhe Zoom Meeting	105,000	104,796
6029099	Shpenzime për hapjen e derës së emergjencës	15,600	15,600
6029099	Mirëmbajtje ëebsite kpa.al	91,000	91,000

Sa i përket kategorive kryesore të shpenzimeve gjatë periudhës janar - dhjetor 2021, sqarojmë si më poshtë:

Në kategorinë ***"Materiale zyre/përgjithshme"***, për vitin 2021, janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4, tonera, pjesë këmbimi për

funksionimin e pajisjeve printer dhe fotokopje, materiale pastrimi ku përfshihen dhe materialet që lidhen me masat e parandalimit të përhapjes së Covid-19, (maska, solucion dezinfektues) etj.

Në kategorinë ***"Materiale/shërbime speciale"***, për vitin 2021, janë realizuar procedurat e prokurimit që lidhen kryesisht më furnizimin me ujë të pijshëm për seancat gjyqësorëe dhe stafin e Kolegjit, abonimin në shtypin e shkruar, shërbimin e dezinfektimit të ambienteve të Kolegjit si masë parandaluese për COVID-19, në zbatim të rregullores "Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", prodhimin e regjistrave për sekretarinë gjyqësore etj.

Në kategorinë ***"Shërbime nga të tretë"***, përfshihen kryesisht shpenzime të cilat shtrihen në kohë gjatë gjithë vitit për energji, ujë, shërbim postar dhe shërbimi i telefonisë celulare për Kryetarin dhe personelin e Kolegjit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 855, datë 04.11.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 02.09.2020, "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë".

Gjithashtu në këtë kategori janë përfshirë fondet për publikimin në media të vendeve vakante në institucion sipas përcaktimeve në rregulloren "Për Veprimtarinë e Komitetit Ad Hoc për administrimin e procesit të emërimeve në Kolegjin e Posaçëm Të Apelimit", kreu II, pika 1. Gjatë periudhës janar - dhjetor janë shpallur 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione vakante, në bazë të së cilave janë zhvilluar dhe procedurat e rekrutimit.

Në kategorinë **"Shërbime transporti"**, është realizuar procedura e prokurimit në lidhje më furnizimin me karburant për automjetin e institucionit, si dhe është lidhur kontrata më Bashkinë Tiranë për vend parkimin e automjetit. Gjithashtu gjatë kësaj periudhë është prokuruar sigurimi i detyrueshëm dhe sigurimi "Casko" për këtë automjet.

Në kategorinë **"Mirëmbajtje të zakonshme"**, është kryer shërbimi i mirëmbajtjes periodik për automjetin e institucionit, shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit video të instaluar në sallën e gjyqit, si pjesë e kontratës së prokurimit si dhe riparimi i disa pajisjeve elektronike.

Në kategorinë **"Shpenzime të tjera operative",** vlera kryesore lidhet me zhvillimin e procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar", Marrëveshje Kuadër (në bashkëpunim me organin qëndror blerës, ABP), me objekt "Sigurimi i jetës, shëndetit dhe pasurisë për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit", me fond të përgjithshëm të Marrëveshjes Kuadër 6.410.000 (gjashtë milion e katërqind e dhjetë mijë) lekë, e ndarë në dy lote. Gjithashtu në këtë kategori janë përfshirë shpenzimet për kompensimin e gjyqtarëve të Kolegjit për shërbimin e telefonisë celulare për periudhën janar - mars 2021, pagesa për taksa/tarifa për Bashkinë Tiranë dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për shërbime të kryera lidhur me vënien në dispozicion të Kolegjit të dokumentacionit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, rinovimi i licencave të shërbimit Microsoft Office 365 dhe Zoom Meeting, si dhe materiale të ndryshme hidraulike të nevojshme për tu përdorur nga punonjësi mirëmbajtës i Kolegjit, në funksion të nevojave të ndryshme ditore të veprimtarisë së institucionit.

IV - Transferta për buxhetet familiare dhe individët (llogaria ekonomike 606)

N/artik	Struktura e llogarive	Plani vjetor (në lekë)	Fakti Progresiv (në lekë)	Realizmi në %
606	Transferta për buxhetet familiare dhe individët	**1,364,000**	**906,196**	**66.5%**

Në këtë fond janë përfshirë fond i veçantë në vlerë 264 mijë lekë, miratuar për Kolegjin gjatë vitit 2021, si dhe fondi prej 1.100 mijë lekë për rimbursimin e shpenzimeve telefonike nga muaji prill 2021, e në vijim, për gjyqtarët e Kolegjit të Posacëm të Apelimit (transferuar nga artikulli 602 "Mallra dhe shërbime të tjera", sipas parashikimit në udhëzimin plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021".)

Nga ky fond, bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 929, datë 17.11.2010, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" të ndryshuar, janë kryer pagesa si shpërblim për daljen në pension, në një rast, në vlerën 73.940 lekë, pagesa në formën e ndihmës për sëmundje në dy raste, në vlerën 50 mijë lekë për secilin rast si dhe pagesa në formën e ndihmës për fatkeqësi në familje, në tre raste në vlerën 30 mijë lekë për secilin rast. Gjithashtu janë kryer kompensimet e shërbimit telefonik për gjyqtarët për muajt prill - dhjetor 2021.

V. <u>Investime kapitale (llogaria ekonomike 231)</u>

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2021, në investime është ***8 milionë lekë*** dhe përbën 5 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin investime, për periudhën janar-dhjetor 2021, është ***8 milionë*** lekë dhe realizimi ***2.85 milionë*** lekë ose 35.6 % sipas tabelës së mëposhtme.

N/artik	Struktura e llogarive	Plani vjetor (në lekë)	Fakti Progresiv (në lekë)	Realizmi në %
231	**Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupezuara**	**8,000,000**	**2,847,500**	**35.60%**
2318100	Shpenz. Pajisje dhe mobilje zyre	4,000,000	809.000	19.80%
2318200	Shpenz. Pajisje kompjuteri (blerje pajisje elektronike)	4,000,000	2,038,500	50.96%

Buxheti i miratuar në investime për vitin 2021, ishte më i lartë se parashikimet e kryera për prokurimin e pajisjeve elektronike dhe pajisjeve e mobiljeve të zyrave, për krijimin e kushteve të punës për punonjësit shtesë të miratuar në strukturën organike të Kolegjit, si dhe të nevojave që lidhen me ambientet në katin e parë të godinës, ku aktualisht vijon të qëndrojë Shoqata e të Përndjekurve Antikomunistë në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 230, datë 26.04.2018, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Kuvendit të Republikës".

Në mungesë të kalimit në përdorim të Kolegjit të këtyre ambienteve, sipas VKM-së sipërcituar, janë kryer proceduarat e prokurimeve për plotësimin e nevojat që lidhen me shtesën në strukturën organike të Kolegjit.

Bashkëlidhur lutem gjeni formatet standarde për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.